



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr. 10 091, datë 5.03.2009

**PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT
LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR, I NDRYSHUAR ¹**

(ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", me ligjin 47/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, dhe me ligjin Nr. 126/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi dhe objekti**

1. Ky ligj ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të audituesit ligjor, si dhe rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar.
2. Ky ligj parashikon dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara dhe dhënien e sigurisë për raportimin vjetor dhe të konsoliduar të qëndrueshmërisë, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, të shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit.

¹ Ky projektligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 maj 2006, "Mbi kontrollet ligjore të llogarive vjetore dhe të konsoliduara", që ndryshon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 84/253/KEE. Numri CELEX 32006L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 9.6.2006, f. 87–107;
- Rregulloren (BE) nr. 537/2014, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 prill 2014, "Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin ligjor të subjekteve me interes publik" dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit 2005/909/KE. Numri CELEX 32014R0537, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 158, datë 27.5.2014, f. 77–112

Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Auditim ligjor” është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara, nëse:
 - a) kërkohet nga ky ligj;
 - b) kërkohet nga ligje të tjera;
 - c) kryhet në mënyrë vullnetare, me kërkesë të ortakëve/aksionerëve të njësisë ekonomike, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit të shpallura të detyrueshme dhe kërkesave të këtij ligji.
2. “Auditues ligjor i huaj” është personi i miratuar dhe i regjistruar për kryerjen në një shtet tjetër të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale ose të konsoliduara, apo për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë së personave juridikë, kur kjo e fundit është e zbatueshme.
3. “Auditues i grupit” është një ose disa auditues ligjorë apo një ose disa shoqëri auditimi, që kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara, ose dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme.
4. “Komision i provimeve të aftësive profesionale” është struktura që merret me testimet e kandidatëve për auditues ligjorë dhe kontabilistë të miratuar, të cilat organizohen në kuadër të provimit përfundimtar dhe të aftësive profesionale.
“Komiteti i regjistrimit” është struktura e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, që merret me procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.
5. “Bordi i Mbikëqyrjes Publike” është organi kolegjal i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i cili ka, gjithashtu, kompetenca edhe për mbikëqyrjen e organizmave profesionale të kontabilistëve të miratuar.
6. “Auditues ligjor” është personi i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore dhe për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme, i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”
7. “Kandidat” është person, i cili është pranuar nga organizmi profesional i audituesve ligjorë, për të kryer praktikën profesionale të përgatitjes teoriko-praktike pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie auditimi.
8. “Kontabilist i miratuar” është person, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
9. “Organizata profesionale e audituesve ligjorë” është organizmi profesional, që grupon audituesve ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” është emërtimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë e cila është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr.3573, datë 16.10.1998. Ky emërtim mund të ndryshohet, në përputhje me procedurat statutores të organizatës.
10. “Organizata profesionale të kontabilistëve të miratuar” janë organizimet e profesionistëve kontabilistë, që kanë jo më pak se 50 anëtarë, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimeve të kontabilitetit, të organizuar përkatësisht në njërin nga organizatat profesionale të kontabilistëve, në të cilat përfshihen edhe shoqëritë e kontabilitetit.
11. “Ortaku kryesor i auditimit” është:
 - a) audituesi ligjor i cili, në një angazhim auditimi, është ngarkuar nga shoqëria e auditimit me përgjegjësinë kryesore për kryerjen e auditimit ligjor në emër të

shoqërisë së auditimit;

b) në rastin e një auditimi të shoqërive të grupit, audituesi ligjor, i cili është ngarkuar nga shoqëria e auditimit me përgjegjësinë kryesore për kryerjen e auditimit të grupit;

c) audituesi ligjor që nënshkruan raportin e auditimit.

12/1. “Ortaku kryesor i qëndrueshmërisë” është:

- a) audituesi ligjor i caktuar nga një shoqëri audituese si përgjegjësi kryesor për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në një angazhim të veçantë për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë; ose
 - b) në rastin e dhënies së sigurisë për raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë të paktën audituesi ligjor i caktuar si përgjegjësi kryesor për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në nivel të grupit dhe audituesi ligjor i caktuar si përgjegjësi kryesor në nivel të shoqërive të kontrolluara ekzistuese; ose
 - c) audituesi ligjor që nënshkruan raportin për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
12. “Jopraktikues” është çdo individ me njohuri në fushën e auditimit ligjor dhe në fusha të lidhura me të, i cili, gjatë angazhimit në qeverisjen e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe për periudhën e fundit trevjeçare, përpara këtij angazhimi, nuk ka kryer auditime ligjore, nuk ka pasur të drejtë vote në një shoqëri auditimi, nuk ka qenë anëtar i organit administrativ, mbikëqyrës apo drejtues i një shoqërie auditimi dhe nuk ka qenë i punësuar apo i angazhuar në forma të tjera në një shoqëri auditimi.
13. “Raporti i auditimit” është raporti që përgatitet nga audituesi ligjor ose nga shoqëria e auditimit në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, si edhe me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.
14. “Regjistri publik i audituesve ligjorë” është regjistri i audituesve ligjorë, audituesve ligjorë të huaj dhe shoqërive të auditimit, vendase e të huaja, të cilat autorizohen të angazhohen në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe të konsoliduara të entiteteve, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.
15. “Rrjet i audituesve ligjorë” është një strukturë e madhe bashkëpunimi, ku marrin pjesë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, e cila ka për qëllim realizimin e ndarjes së fitimit apo kostos, pronësinë, drejtimin ose kontrollin e përbashkët, përdorimin e politikave dhe procedurave të njëjta të kontrollit të cilësisë, strategji biznesi të përbashkët, përdorimin e të njëjtit emër tregtar ose të një pjese të rëndësishme të burimeve profesionale.
16. “Standardet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë” (SNAS) janë standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA), standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë (SNMC) dhe standardet e tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe të publikuara në gjuhën shqipe, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, si dhe të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja.
17. “Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar” janë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe interpretimet përkatëse (interpretimet e komitetit të përhershëm) (IKP) dhe interpretimet e komitetit të raportimit financiar ndërkombëtar (IKRFN), të miratuara nga bordi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (BSNK - IASB).
18. “Shërbimet e kontabilitetit” janë shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave kontabël, fiskalë dhe të pagave, të kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit kontabël, vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit, vlerësimit dhe zbatimit të procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare, analiza financiare dhe këshillime përkatëse, si dhe shërbime të tjera të ngjashme.
19. “Shoqëri auditimi” është një person juridik, pavarësisht formës së organizimit, regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i cili plotëson kriteret e

parashikuara në këtë ligj, si dhe është i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore dhe, ku është e zbatueshme, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi, për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Shoqëritë audituese të huaja që operojnë në Shqipëri respektojnë të njëjtat kritere dhe regjistrohen në përputhje me këtë ligj.

20. “Shoqëri audituese e huaj” është personi juridik, i krijuar në përputhje me ligjin e një shteti tjetër, i cili është regjistruar apo licencuar në atë shtet për kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara të subjekteve **apo, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të njësive ekonomike në një shtet tjetër, kur kjo e fundit është e zbatueshme.**
21. “Shoqëri e lidhur me shoqërinë audituese” është çdo shoqëri tjetër, që lidhet me shoqërinë audituese nëpërmjet pronësisë, kontrollit, drejtimit të përbashkët.
22. “Njësi ekonomike me interes publik” janë:
 - a) të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
 - b) bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
 - c) **shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat, shoqëritë komisionere, institucionet e tregut, si: bursa, depozitari qendror i titujve, shtëpia e klerimit/kundërpala qendrore të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;**
 - ç) shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
23. “Raportimi i qëndrueshmërisë” është detyrimi ligjor i njësive ekonomike për përgatitjen e raporteve zyrtare dhe të detyrueshme, publikimin e informacioneve jofinanciare, zbulimin e plotë dhe transparent të ndikimeve mjedisore, çështjeve sociale dhe të punësimit, respektimit të të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit, përputhjen me standarde dhe legjislacionin në fuqi dhe raportimin sipas formateve dhe afateve të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.
24. “Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë” është kryerja e procedurave që formojnë një opinion të shprehur nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese, bazuar në një angazhim të dhënies së sigurisë së kufizuar, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi çështjet e qëndrueshmërisë. Këtu përfshihet pajtueshmëria e raportimit të qëndrueshmërisë me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë të shpallura për zbatim në legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe në procesin e realizuar nga njësia ekonomike për identifikimin e informacionit të publikuar, në zbatim të standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë dhe të kërkesave të tjera të zbatueshme për raportin e qëndrueshmërisë.
25. “Skepticizëm profesional” nënkupton një qëndrim, që përfshin një opinion dyshues, të qenët vigjilent ndaj rrethanave, që mund të tregojnë për anomali të mundshme për shkak të gabimit ose të mashtrimit, dhe një vlerësim kritik të dokumentacionit, që i nënshtrohet auditimit.
26. “Qëndrueshmëri” nënkupton detyrimin ligjor të njësive ekonomike për të menaxhuar dhe raportuar ndikimet aktuale dhe potenciale të aktiviteteve të tyre mbi çështjet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, duke përfshirë:
 - a) përmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
 - b) respektimin e të drejtave sociale dhe të punës;
 - c) luftën kundër korrupsionit dhe ryshfetit;
 - ç) garantimin e transparencës së plotë në operime;
 - d) çdo aspekt tjetër sipas ligjeve specifike në fuqi.

KREU II

MBIKËQYRJA PUBLIKE E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE SHOQËRIVE AUDITUESE

Neni 3

Mbikëqyrja publike

1. Mbikëqyrja e profesionit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese realizohet nga bordi i mbikëqyrjes publike, si drejtpërdrejt, duke mbikëqyrur të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, ashtu edhe përmes mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
2. Qëllimi i sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese është të rrisë sigurinë, që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik.

Neni 4

Bordi i Mbikëqyrjes Publike

1. Për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë, krijohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur me cilësinë e personit juridik publik, me qendër në Tiranë.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga 5 anëtarë jopraktikues, të cilët kanë njohuri për auditimin ligjor dhe fusha të lidhura me të.
3. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë, si më poshtë:
 - a) kryetari dhe tre anëtarë propozohen nga Ministri i Financave, njëri prej të cilëve përzgjidhet nga institucionet e arsimit të lartë;
 - b) një anëtar propozohet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.
4. Anëtarët e bordit përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë shtetësi shqiptare;
 - b) të kenë integritet moral dhe profesional;
 - c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
 - ç) të zotërojnë, të paktën, diplomë “Master i shkencave” apo të barasvlershëm me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 10 vite përvojë, ose një gradë apo titull shkencor dhe 7 vite përvojë pune në çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;
 - d) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
5. Bordi, në ushtrimin e funksioneve të veta mbikëqyrëse, të sigurimit të cilësisë dhe administrative, asistohet nga një strukturë mbështetëse. Punonjësit e kësaj strukture, që do të angazhohen në kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të plotësojnë, të paktën, kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të kenë jo më pak se 7 (vjet) vjet përvojë pune në fushën e auditimit ligjor e të raportimit financiar dhe në raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të tjera të lidhura të qëndrueshmërisë, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së

- cilësisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme.
- b) të mos ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jenë të punësuar apo të angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
 - c) të mos kenë konflikt interesi ndërmjet tyre dhe me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit. Këta punonjës, përpara nisjes së procesit të sigurimit të cilësisë, plotësojnë një deklaratë me shkrim, ku deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi me audituesin ligjor dhe/ose shoqërinë e auditimit, objekt të kontrollit të cilësisë.
6. Si përjashtim i shkronjës “b”, të pikës 5, të këtij neni, bordi mund të asistohet nga ekspertë për të kryer kontrolle cilësie specifike, në rastet kur:
- a) numri i punonjësve të strukturës mbështetëse, që mbulojnë çështjet e dhënies së sigurisë për cilësinë është i pamjaftueshëm;
 - b) kur kjo konsiderohet thelbësore për kryerjen, në mënyrën e duhur, të kontrollit të cilësisë.
- Ekspertët që angazhohen duhet të plotësojnë kërkesat e pikës 5, të këtij neni, dhe nuk duhet të jenë të përfshirë në qeverisjen ose të punësuar apo të kontraktuar në organizata të tjera profesionale, por mund të jenë anëtarë të këtyre organizatave.
7. Punonjësit që mbulojnë çështjet e sigurimit të cilësisë nuk mund të kryejnë kontroll cilësie për një auditues ligjor ose shoqëri auditimi derisa të kenë kaluar, të paktën, tre vjet që nga momenti që ky person ka pushuar së qeni partner, i punësuar, apo i lidhur me këtë auditues ligjor apo shoqëri auditimi.
8. Organika e strukturës mbështetëse miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të strukturës mbështetëse rregullohen në përputhje me Kodin e Punës.
9. Këshilli i Ministrave miraton:
- a) procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve të bordit;
 - b) rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
 - c) shpërblimin e anëtarëve të bordit;
 - d) mënyrën e funksionimit dhe nivelin e pagave të strukturës mbështetëse.

Neni 4/1

Financimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

1. Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike bëhet:
- a) nëpërmjet të ardhurave të mbledhura nga:
 - i. pagesa prej 3 për qind, e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik;
 - ii. Fonde të tjera në masën jo më shumë se 10% si kontribut i organizatave profesionale subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
 - iii. shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - iv. teprica të papërdorura nga proceset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë;
 - v. fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit;
 - b) nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit.
2. Të ardhurat e siguruara, sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren nga bordi për financimin e veprimtarisë e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Teprica e të ardhurave, në fund të vitit buxhetor aktual, kalon në reduktim të masës së financimit nga Buxheti i Shtetit për

vitin pasardhës.

3. Procedura dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
4. Shuma prej 20% e të ardhurave të arkëtuara nga gjobat e vendosura nga organizatat profesionale derdhet në buxhetin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e bordit të mbikëqyrjes publike

1. Bordi ka këto të drejta dhe detyra:
 - a) harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
 - b) mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
 - c) miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
 - ç) miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
 - d) mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
 - dh) mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
 - e) miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
 - ë) kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
 - f) shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
 - g) miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
 - gj) shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
 - h) shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij.
 - i) harton dhe miraton pasqyrat financiare të tij në përputhje me kërkesat përkatëse të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe miraton audituesin ligjor ose shoqërinë audituese të tyre;
 - j) nxjerr akte, që janë rregullat, rregulloret, urdhrat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin e funksionimit të tij. Aktet me karakter normativ rregullator botohen në Fletoren Zyrtare.
 - k) shpall të detyrueshme standardet profesionale të zbatueshme nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit në përputhje me fushëveprimin e këtij ligji, të cilat botohen në Fletoren Zyrtare;
 - l) miraton aktet rregullatore lidhur me bashkëpunimin e shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.
2. Bordi miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

Neni 6

Raportimi

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, për veprimtarinë që ushtron në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend brenda 4-mujorit të parë të vitit pasardhës.
2. Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

KREU III

ORGANIZATA PROFESIONALE E AUDITUESVE LIGJORE DHE E SHOQËRIVE AUDITUESE

Neni 7

Organizimi i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese

1. Profesionistët kontabël, që e ushtrojnë veprimtarinë si auditues ligjorë, grupohen në një organizim të vetëm profesional, që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë organizimin e veprimtarisë së profesionit të audituesit ligjor dhe që organizohet si person juridik, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e tij. Për të gjitha ato çështje që nuk rregullohen në këtë ligj zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri.
2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë grupon të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, vendase e të huaja, të cilat janë regjistruar të tilla, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara, të shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë.
3. Përveç rregullave të parashikuara nga ky ligj, statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë përcakton rregulla të hollësishme për organizimin, kriteret e zgjedhjes apo emërimit, funksionimin dhe detyrat e organeve të tij. Statuti miratohet nga Ministri i Financave, pasi merret mendimi paraprak nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Neni 8

Organizimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë

Organet e organizatës profesionale të audituesve ligjorë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- b) Këshilli Drejtues;
- c) Komiteti i Kontrollit të Brendshëm;
- c) Drejtori Ekzekutiv.

Neni 9

Asambleja e përgjithshme e anëtarëve

1. Organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e përgjithshme e anëtarëve, e cila mbledhet të paktën një herë në vit dhe, përveç kompetencave të tjera të parashikuara nga statuti, ka edhe këto kompetenca:
 - a) me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e këshillit drejtues, ndër individët që kanë paraqitur kandidaturën për këto poste, të cilët më pas zgjedhin kryetarin, zëvendëskryetarin dhe drejtorin ekzekutiv, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
 - b) zgjedh anëtarët e komitetit të kontrollit të brendshëm;
2. Asambleja e përgjithshme e anëtarëve mbledhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe me dispozitat e statutit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 10

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues kryen drejtimin e veprimtarisë, në pajtim me vendimet e asamblesë së përgjithshme të anëtarëve, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij.
Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë dhe organizohet si më poshtë:
 - a) Kryetari;
 - b) Zëvendëskryetari;
 - c) Anëtarë përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.
2. Kryetari i Këshillit Drejtues është organi që përfaqëson organizatën profesionale të audituesve ligjorë. Ai ka, gjithashtu, kompetencën për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të anëtarëve. Në rast pamundësie apo pengimi, zëvendëskryetari mund ta thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të anëtarëve. Statuti mund të miratojë rregulla të tjera shtesë, për raste të tjera të thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
3. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Anëtarët e tjerë të këshillit drejtues zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm pas kalimit të një afati katërvjeçar nga përfundimi i mandatit.
4. Kriteret e përzgjedhjes së individëve, që emërohen në këshillin drejtues, të drejtat dhe detyrimet e këshillit drejtues, veprimtaria, si dhe procedurat e vendimmarrjes së këshillit drejtues rregullohen nga statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 11

Administrimi i veprimtarisë së organizimit profesional të audituesve ligjorë

1. Administrimi i përditshëm i veprimtarisë kryhet nëpërmjet organeve administrative, që drejtohen nga drejtori ekzekutiv.
2. Funkcionet në organet e zgjedhura nuk rregullohen në bazë të ndonjë kontrate punësimi. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mund të miratojë shpërblime fikse për pjesëmarrje të personave të zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese.
3. Anëtarët e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, të Komitetit të Regjistrimit dhe anëtarët e komisioneve apo komiteteve, të parashikuara nga ky ligj apo nga statuti i organizatës së audituesve ligjorë, kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Masa e këtij shpërblimi miratohet nga bordi, sipas propozimit të Këshillit Drejtues.
4. Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës dhe të komiteteve apo komisioneve, të përmendura në pikën 3 të këtij neni, gëzojnë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera prej tyre për shërbime në interes të organizatës, përkundrejt paraqitjes së dokumenteve justifikuese përkatëse.

Neni 12

Kompetencat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit, në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.
2. Organizata profesionale e ar audituesve ligjorë ka këto të drejta e detyra:
 - a) harton kurrikulat për programin e përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për kandidatët që kërkojnë të hyjnë në profesion, bazuar në standardet e pranuar ndërkombëtare të edukimit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit

- Kontabël, dhe organizon e monitoron procesin e trajnimit;
- b) harton dhe miraton rregullat e praktikës profesionale ku parashikohen hollësi për komisionin e stazhit, hyrjen në praktikën profesionale, kualifikimin, ndjekjen, raportimin, kontrollin, testimin paraprak, raportimet periodike, si dhe drejtuesit e praktikës profesionale;
 - c) harton programet e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të tij, përcakton rregullat për organizimin dhe monitorimin e kualifikimit të vijueshëm të tyre, ku përfshihen mënyrat dhe format e kryerjes së trajnimit, monitorimi, njohja dhe ekuivalentimi i formave të ndryshme të trajnimit, që realizohen nga palë të treta, si dhe organizon e monitoron kualifikimin e vijueshëm.
 - ç) realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik në përputhje me aktin e delegimit nga BMP-ja, si edhe kryen investigimin e rasteve të shkeljeve të standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse të etikës në zbatim të rregullores së investigimit e të disiplinës për aspekte brenda objektit të vet. Në aktin e delegimit specifikohen detyrat e deleguara dhe kushtet në të cilat ato do të kryhen. Organizata profesionale e audituesve ligjorë e realizon procesin e kontrollit të sigurimit të cilësisë në një mënyrë të tillë, që të shmanget konflikti i interesit.
 - d) merr pjesë në organizatat ndërkombëtare të profesionit dhe udhëheq veprimtarinë për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga anëtarësia;
 - dh) mban dhe përditëson regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
 - e) u paraqet organeve dhe institucioneve shtetërore çdo informacion për profesionin, në bazë të të cilit janë organizuar anëtarët e vet, si dhe ka detyrë të paraqitet kur thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me këtë profesion;
 - ë) siguron se anëtarët e tij zbatojnë praktikën më të mira në fushën e standardeve profesionale dhe të etikës;
 - f) kryen çdo detyrë tjetër, që është brenda objektit të veprimtarisë, të përcaktuar në këtë ligj dhe në statut;
 - g) përgatit akte vetërregullatore dhe/ose akte të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji, të cilat i nënshtrohen miratimit nga BMP, me përjashtim të statutit të organizatës, i cili miratohet nga Ministri i Financave.”.
3. Statuti parashikon organet e ngarkuara për plotësimin dhe ndjekjen e secilës prej detyrave dhe kompetencave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 13

Burimet dhe përdorimi i të ardhurave

1. Pasuria e organizatës profesionale të audituesve ligjorë përbëhet nga:
 - a) gjendja e trashëguar nga veprimtaria e Institutit të Audituesve Ligjorë;
 - b) të ardhurat nga kuotat, që paguajnë anëtarët e tij, të cilat përcaktohen sipas statutit;
 - c) shumat e arkëtuara për gjobat dhe penalitetet e vendosura ndaj anëtarëve të tij, në rast të shkeljeve disiplinore;
 - ç) të ardhurat nga veprimtari të tilla, si publikimi i materialeve, kualifikimi i stazhierëve dhe i vijueshëm, si dhe shërbime që kryen për të tretët;
 - d) të ardhurat nga investimet e aktiveve;
 - dh) donacionet, projektet dhe të ngjashme, të dhëna në kuadër të zhvillimit të profesionit;
 - e) të ardhura të tjera nga burime të ligjshme.
2. Vendimarrja për përdorimin e fondeve i nënshtrohet dispozitave të statutit të organizatës.

Neni 14
Procedurat e investigimit dhe të marrjes së masave disiplinore

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë vë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të disiplinës, si dhe respekton procedurat e kryerjes së investigimit, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive, që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera dhe të lidhura nga audituesit ligjorë.
2. Rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore miratohen nga bordi, sipas propozimit të këshillit drejtues. Këshilli drejtues, kur kjo i kërkohet, vë në dispozicion stafin e vet dhe asiston bordin, me cilësinë e sekretariatit teknik.
3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron publikimin e masave të marra dhe/ose sanksioneve të dhëna nga bordi ndaj audituesve ligjorë ose shoqërive audituese.

KREU IV
AUDITUESI LIGJOR DHE SHOQËRIA AUDITUESE

Seksioni I
Përgatitja e audituesve ligjorë

Neni 15
Praktika profesionale dhe hyrja në profesion

1. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të ketë:
 - a) përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj për hyrjen në profesion;
 - b) kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale, të hartuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji;
 - c) kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 (tre) vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose të pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë, që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim. Gjatë kësaj praktike, për të paktën tetë muaj, të jetë ushtruar në dhënien e sigurisë për raportimin vjetor dhe të konsoliduar të qëndrueshmërisë ose në shërbime të tjera që lidhen me qëndrueshmërinë. Të paktën dy të tretat e praktikës profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie audituese, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. Kandidati duhet të vërtetojë se gjatë praktikës profesionale me një auditues ligjor apo një shoqëri audituese ka kryer jo më pak se 600 orë pune në vit, si i angazhuar në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara.
3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë, sipas kompetencave të parashikuara në statut, siguron që praktika profesionale të kryhet në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.
4. Audituesi ligjor apo shoqëria audituese, që ka nënshkruar kontratë me kandidatin, i raporton organizatës profesionale të audituesve ligjorë çdo gjashtë muaj për ecurinë e kandidatit dhe përfundimin e praktikës profesionale.
5. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët duhet të përmbushin detyrimet e

praktikës profesionale dhe të punës, të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli nga ana e organizatës profesionale të audituesve ligjorë për punën e tyre.

6. Përjashtohen vetëm nga detyrimi për të kryer praktikën profesionale, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, individët që, për pesëmbëdhjetë vjet, kanë qenë të angazhuar në veprimtari profesionale, të cilat u kanë dhënë mundësi të fitojnë përvojën e mjaftueshme në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit.

Këta individë i nënshtrohen të njëjtit proces testimi, të cilit i nënshtrohen edhe kandidatët. Propozimi për çdo rast përjashtimi nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale bëhet me vendim të këshillit drejtues të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe miratohet nga bordi i mbikëqyrjes publike. Kopje e vendimit i dërgohet Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale.

7. Shfuqizohet.

Neni 16

Kushtet e pranimit të kandidatëve në praktikën profesionale

Për t'u pranuar në praktikën profesionale, kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
- c) çfuqizohet;
- ç) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel për çdonjerën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barasvlershme me to.

Seksioni II

Testimi dhe regjistrimi i audituesve ligjorë

Neni 17

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

1. Për të realizuar testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike ngrihet dhe funksionon Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP).
2. Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) kryetari nga Ministri i Financave;
 - b) dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
 - c) një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; ç) një anëtar nga profesori i fushës të universiteteve.

3. Përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudentës, të lidhura me auditimin, kontabilitetin e financën, me përvojë profesionale jo më të vogël se dhjetë vjet, ose 7 vite përvojë pune, në rast se mbajnë një gradë apo titull shkencor.
4. Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale merret me zbatimin e procedurave të testimit, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve që kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.
5. Rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale hartohen dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
6. Rregullat, procedurat e testimit dhe sistemi i vlerësimit për çdo disiplinë të parashikuar në nenin 18, të këtij ligji, propozohen nga organizata e audituesve ligjorë dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
7. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Neni 18 **Provimi i aftësive profesionale**

1. Për të kryer testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, kandidatët duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale, e cila depozitohet pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Ajo duhet të shoqërohet me dokumentet e nevojshme, që tregojnë përmbushjen e kërkesave dhe pranimin në praktikën profesionale, ose që kandidati ka fituar të drejtën e përjashtimit nga kryerja e praktikës profesionale.
2. Të gjitha testet për njohuritë e aftësive profesionale duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të edukimit IAESB. Sistemi i provimeve të aftësive teorike profesionale duhet të përfshijë, në veçanti, disiplinat:
 - a) teori dhe parime të kontabilitetit;
 - b) kërkesat ligjore dhe standardet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të konsoliduara;
 - c) standardet ndërkombëtare të kontabilitetit; ç) analizë financiare;
 - d) kontabilitet kostoje dhe drejtimi;
 - dh) menaxhim risku dhe kontroll i brendshëm;
 - e) auditimi dhe aftësitë/zotësitë profesionale;
 - ë) kërkesat ligjore dhe standardet profesionale për auditimin ligjor dhe audituesit ligjorë;
 - f) standardet ndërkombëtare të auditimit;
 - g) etika profesionale dhe pavarësia.
3. Sistemi i testimit duhet të mbulojë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, edhe disiplinat e mëposhtme:
 - a) legjislacioni për shoqëritë tregtare dhe qeverisja e shoqërive tregtare;
 - b) legjislacioni dhe procedurat e falimentimit;
 - c) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë; ç) e drejta civile;

- d) legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe e drejta e punës në Republikën e Shqipërisë;
- dh) teknologjia e informacionit dhe sistemet kompjuterike;
- e) ekonomiks;
- ë) matematikë dhe statistikë;
- f) parimet bazë të menaxhimit financiar.

Programi i përgatitjes profesionale hartohet çdo vit nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.

4. Përpara se të marrin pjesë në testimet e parashikuara në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, kandidatët duhet të provojnë se kanë kaluar me sukses të gjitha provimet e aftësive teorike profesionale, që përfshihen në programin e miratuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, të hartuar sipas kërkesave të pikave 2 e 3, të këtij neni. Për të gjitha ato disiplina, që nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë, organizohen provime të veçanta nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, me të cilat ajo ka nënshkruar marrëveshje.
5. Provimi përfundimtar i aftësive profesionale garanton shkallën e nevojshme të njohurive teorike rreth disiplinave që lidhen me auditimin ligjor dhe aftësinë për të vënë në praktikë njohuri të tilla. Ai realizohet nëpërmjet jo më pak se 4 testeve me shkrim dhe përfshin vlerësimin e aftësive të kandidatëve për auditues ligjorë, për të zbatuar në praktikë e për të bërë gjykime profesionale në një shkallë të avancuar, në fushat e mëposhtme:
 - a) raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar;
 - b) zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare;
 - c) zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit;
 - d) zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë);
 - dh) përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.
6. Testimet, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, zhvillohen, të paktën, një herë në vit, në datat e miratuara nga Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale.
- 6/1. Provimi i aftësive profesionale për dhënien e sigurisë së raportimit të qëndrueshmërisë duhet të garantojë njohuritë teorike dhe aftësinë për të vënë në praktikë këto njohuri, sipas disiplinave të mëposhtme:
 - a) legjislacioni dhe standardet në zbatim për përgatitjen e raportimit vjetor dhe të konsoliduar të qëndrueshmërisë në Republikën e Shqipërisë;
 - b) analiza e qëndrueshmërisë;
 - c) proceset e kujdesit të duhur në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë;
 - ç) kërkesat ligjore dhe standardet në lidhje me dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë sipas nenit 37 të këtij ligji;
7. Kandidatët që kanë fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, pasi kanë kaluar testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, që parashikohen në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij neni, kalojnë drejtpërdrejt në testet e disiplinave të tjera të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d”, dhe “dh”, të pikës 5, të këtij neni, nëse kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 15, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, dhe kushtet dhe programi i provimeve të dhëna nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, për shkak të ndryshimeve thelbësore të legjislacionit

të përfshirë në këto nënndarje.

8. Kostot administrative të organizimit të testimit përballohen nga kandidatët.
9. Shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë kaluar një provim universitar apo ekuivalent, ose kanë një diplomë universitare apo kualifikim ekuivalent në një apo më shumë nga disiplinat e përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, mund të përjashtohen nga testimi i aftësive teorike profesionale për disiplinat e mbuluara nga këto provime ose diploma.
10. Përjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale dhe detyrohen të kryejnë vetëm testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, në disiplinat e legjislacionit fiskal, të shoqërive tregtare, të sigurimeve shoqërore, të drejtën e punës dhe të drejtën civile, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, kuadrin ligjor dhe rregullator në masën që i takojnë dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar titullin “Auditues ligjor” apo ekuivalentin e tij, si edhe ata që janë miratuar për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë dhe janë të regjistruar për të ushtruar veprimtarinë si anëtarë të një organizate profesionale të audituesve ligjorë në një shtet tjetër, kur programi i përgatitjes së tyre vlerësohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë se është në pajtueshmëri, në masën jo më pak se 75 (shtatëdhjetë e pesë) për qind me programin e përgatitjes së audituesve ligjorë në Shqipëri.
11. Rregullat, procedurat dhe dokumentacioni që paraqitet për përjashtimin nga testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me propozimin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 19

Komiteti i Regjistrimit

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë krijon një komitet për zbatimin e procedurave të regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit, vendas/e dhe të huaj/a.
2. Komiteti i Regjistrimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) tre anëtarë, nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë;
 - b) dy anëtarë, respektivisht nga ministria përgjegjëse për financat dhe ministria përgjegjëse për ekonominë, me profil në fushën e ekonomisë dhe/ose jurisprudencës, si dhe me njohuri në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financës.
3. Rregullat e hollësishme të funksionimit të Komitetit të Regjistrimit dhe procedurat e marrjes së vendimeve e të miratimit të regjistrimit hartohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
4. Administrimi i procesit të regjistrimit bëhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë. Kostot e regjistrimit përballohen nga kandidatët që kërkojnë regjistrim, të cilët paguajnë një tarifë për regjistrim dhe çregjistrim, masa e së cilës përcaktohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, bazuar në kostot mesatare të regjistrimit. Tarifa e regjistrimit është e ndryshme për kërkesat për regjistrim si shoqëri auditimi dhe për ato si auditues ligjor.
5. Komiteti i Regjistrimit mbledhet një herë në dy muaj, në javën e parë të muajit pasardhës.

Neni 20

Regjistrimi i audituesve ligjorë

1. Regjistrimi i audituesve ligjorë është procesi i përfshirjes së tyre në regjistrin publik të audituesve ligjorë.
2. Kërkesa e kandidatit për regjistrim i adresohet, me shkrim, Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Kërkesa duhet të shoqërohet me

dokumentet e nevojshme, që tregojnë për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale, si dhe të deklaratës së lëshuar në përgjegjësinë personale të individit, për dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale.

3. Audituesit ligjorë nga Komiteti i Regjistrimit përfshihen në regjistrin publik, që mbahet dhe përditësohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë. Vetëm pas kësaj përfshirjeje, ata kanë të drejtë të kryejnë veprimtarinë e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, si edhe të kryejnë shërbime të tjera apo shërbime të lidhura, kur ato nuk bien ndesh me kërkesat e parashikuara në këtë ligj, me standardet profesionale dhe me kodin e etikës.

Neni 21

Regjistrimi i shoqërive audituese

Komitetit i Regjistrimit e regjistron një shoqëri audituese për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se shoqëria audituese plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) është themeluar në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe, kur është e huaj, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- b) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri audituese, vendase ose të huaja, ose nga auditues ligjorë;
- c) shumica deri në maksimumin 75 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese janë auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
- ç) shoqëria angazhon auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë;
- d) shoqëria gëzon reputacion të mirë.

Neni 22

Regjistrimi i audituesve ligjorë të huaj

1. Për t’u regjistruar në regjistrin publik, audituesi ligjor i huaj fillimisht i drejtohet, me një kërkesë me shkrim, për dhënien e provimit të aftësive profesionale, Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, që tregon për titullin e marrë në një shtet tjetër.
2. Përmbajtja e dokumentacionit, që paraqitet për regjistrimin e audituesit ligjor të huaj dhe të shoqërive të huaja audituese në regjistrin publik të audituesve ligjorë përcaktohet nga bordi dhe miratohet nga Ministri i Financave.
3. Këshilli Drejtues i organizatës profesionale bën vlerësimin e pajtueshmërisë së kushteve të përgatitjes së audituesve ligjorë të huaj me kushtet e përgatitjes së audituesve ligjorë vendas dhe i dërgon një raport Komitetit të Regjistrimit.
4. Testi kryhet në gjuhën shqipe ose në atë angleze dhe mbulon njohuritë e mjaftueshme, që i nevojiten audituesit ligjor, për ligjet dhe rregullat që zbatohen në Republikën e Shqipërisë në masën që ato kanë lidhje me kontabilitetin e auditimit ligjor.

Neni 23

Pezullimi i veprimtarisë dhe reregjistrimi në regjistrin publik të audituesit ligjor

1. Audituesi ligjor, me një kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë, mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga ushtrimi i profesionit.
2. Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë veprimtarinë e re, që do të ndërmarrë i interesuari, si dhe periudhën për të cilën kërkohet pezullimi apo, kur kjo periudhë nuk mund të identifikohet, datën, në të cilën kërkohet të fillojë pezullimi.
3. Komiteti i Regjistrimit e shqyrton kërkesën në mbledhjen më të parë dhe, nëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, e miraton kërkesën dhe vendos fshirjen e përkohshme të të interesuarit nga regjistri publik i audituesve ligjorë. Kopje e vendimit i dërgohet regjistrit publik të audituesve ligjorë.
4. Audituesi ligjor ka të drejtë të nisë veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë, me shkrim, organizatën profesionale të audituesve ligjorë, të paktën dhjetë ditë më parë, të ketë shlyer derdhjen e kuotave të tij dhe të ketë pushuar veprimtarinë si auditues ligjor. Në rastet kur auditues ligjor ka nisur veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit dhe Komiteti i Regjistrimit vëren, gjatë shqyrtimit, se veprimtaria e tij e re është e natyrës, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, vendos çregjistrimin e audituesit ligjor nga regjistri publik i audituesve ligjorë.
5. Nga data e njoftimit të vendimit, që shpall fshirjen e përkohshme nga regjistri publik, i interesuari nuk është më anëtar i organizatës profesionale. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e vet profesionin e audituesit ligjor të regjistruar dhe as ta përdorë këtë titull.
6. Fshirja e përkohshme nga regjistri publik, me kërkesën e audituesit ligjor, nuk ka efekt mbi procedurat disiplinore, të nisura për shkeljet e kryera prej tij përpara fshirjes.
7. Anëtar i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit mund të kërkojë reregjistrimin e tij. Reregjistrimi nga Komiteti i Regjistrimit bëhet nëse audituesi ligjor ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.

Neni 24

Heqja e së drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë

1. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri audituese hiqet nga bordi, në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë ligj, të cilat konsiderohen të domosdoshme për autorizimin e regjistrimit.
2. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë, mund të përcaktojë një kohë të arsyeshme, për të rregulluar gjendjen e pjesëmarrjes në kapital apo të pjesëmarrjes në organet drejtuese. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi, gjendja nuk është rregulluar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.
3. E drejta për ushtrimin e profesionit të një audituesi ligjor apo të një shoqërie audituese, mund të hiqet, nëse reputacioni është dëmtuar ndjeshëm. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e profesionit, mund të vendosë pezullimin e ushtrimit të profesionit, duke vënë në dispozicion një periudhë kohe të arsyeshme, e cila është e barabartë me pezullimin, një listë të kërkesave që duhen plotësuar, për të siguruar kthimin e reputacionit të mirë. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi kërkesat nuk janë plotësuar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.
4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, reputacioni i mirë i një audituesi ligjor ose i një shoqërie audituese konsiderohet si i dëmtuar ndjeshëm në rast se vërtetohet një nga situatat e mëposhtme, por pa u kufizuar:

- a) është caktuar nga gjykata një masë shtrënguese e arrestit në shtëpi ose e arrestit në burg për një vepër penale të kryer me dashje;
- b) është caktuar nga gjykata një nga masat ndaluese të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, që i ndalon përkohësisht ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor;
- c) është vendosur një sanksion disiplinor ose administrativ nga institucione të tjera shqiptare ose të huaja për shkelje profesionale dhe të përsëritur;
- c) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, rregullat e moralit dhe të profesionit, rekomandimet e autoriteteve mbikëqyrëse të profesionit apo të autoriteteve të ndryshme mbikëqyrëse të tregut.

Neni 25

Kualifikimi i vijueshëm profesional

1. Audituesit ligjorë i nënshtrohen kualifikimit të vijueshëm profesional, i cili është i detyrueshëm dhe zgjat, të paktën, 40 orë. Periodiciteti i kryerjes së kualifikimit të vijueshëm profesional vendoset nga organizata profesionale.
2. Përveç organizimit nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, kurset për kualifikimin e vijueshëm profesional mund të organizohen edhe nga:
 - a) institucione të arsimit të lartë;
 - b) qendra të tjera të kualifikimit profesional, të cilat kanë mjediset dhe personelin e duhur për garantimin e një kualifikimi cilësor, në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional;
 - c) shoqëri audituese, të cilat kanë kapacitete për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e vet.
3. Institucionet e arsimit të lartë, qendrat e kualifikimit profesional dhe punëdhënësit e përmendur në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional, vënë në dijeni bordin e mbikëqyrjes publike për këtë fakt, përpara fillimit të kësaj veprimtarie, në përputhje me vendimin e marrë në organet e veta vendimmarrëse.
4. Në përfundim të çdo kursi, audituesit ligjor pajiset me vërtetimin e plotësimit të detyrimit, si dhe të vlerësimit të marrë. Vërtetimi depozitohet pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
5. Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë miraton mënyrën e monitorimit dhe të vlerësimit të procesit të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të tij. Si pjesë e procesit të vlerësimit, këshilli drejtues mund të miratojë organizimin e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme, i cili duhet të bëhet jo më shpesh se një herë në tre vjet dhe jo më rrallë se një herë në pesë vjet.
6. Në përfundim të një procedure të nisur monitorimi, organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon rezultatet e monitorimit dhe ia dërgon ato bordit të mbikëqyrjes publike. Bordi i shqyrton dhe merr vendim për masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës. Bordi, gjithashtu, merr vendim për pezullimin e ushtrimit të profesionit nga audituesit ligjorë, që nuk kanë arritur të marrin provimet e lidhura me kualifikimin e vijueshëm, apo çregjistrimin e audituesve ligjorë, të cilët kanë depozituar vërtetime të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm. Kopje të vendimeve i dërgohen Komitetit të Regjistrimit, i cili reflekton ndryshimet në regjistrë.
7. Organizata profesionale e audituesve ligjorë propozon për miratim, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, rregullat e kualifikimit të vijueshëm, të shoqëruara me sanksione, të cilat nisin me gjobë dhe përfundojnë me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre vjet, për mosplotësimin e kërkesës së edukimit të vazhdueshëm.
8. Regjistrimi i audituesve ligjorë për të ushtruar profesionin është i përvitshëm. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm është kusht për mosregjistrimin e audituesve ligjorë në listën e publikueshme për të gjithë vitin pasardhës.

Neni 26

Çregjistrimi i audituesve ligjorë nga regjistri publik

1. Audituesi ligjor fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:
 - a) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklarimit me shkrim, kopje të të cilit i dërgohen organizatës profesionale dhe bordit të mbikëqyrjes publike;
 - b) konstatohen parregullsi në:
 - i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;
 - ii. deklaratimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;
 - iii. dokumentet e në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;
 - c) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;
 - ç) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital;
 - d) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;
 - dh) në përputhje me dispozitat e këtij ligji, bordi ka vendosur çregjistrimin nga regjistri publik;
 - e) individ i regjistruar në regjistrin e audituesve ligjorë arrin moshën **67 vjeç**, me përjashtim të audituesve ligjorë me titull shkencor “Doktor i shkencave” apo me titull më të lartë, të cilët çregjistrohen kur arrijnë moshën **70 vjeç**;
 - ë) vdes.
2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon, në një aneks të veçantë të regjistrit publik të audituesve ligjorë, të gjithë individët e parashikuar në pikën 1, shkronja “e”, të këtij neni. Këta individë mund ta ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri auditimi, të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë, që ka jo më pak se dy ortakë angazhimi dhe nën përgjegjësinë e kësaj të fundit.
3. Shoqëria audituese fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:
 - a) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
 - b) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri auditimi hiqet nga bordi.

Seksioni III

Regjistri publik

Neni 27

Organizimi i regjistrit publik

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë është struktura përgjegjëse që siguron:
 - a) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
 - b) identifikimin e audituesit ligjor dhe të shoqërisë audituese në regjistrin publik, me një numër individual.
2. Informacioni për regjistrimin mbahet në format elektronik dhe vihet në dispozicion të publikut nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Për nevojat e veta, organizata profesionale e audituesve ligjorë mund të mbajë edhe regjistër në formë dokumentare.
3. Format i regjistrit publik të audituesve ligjorë miratohet nga bordi dhe ai duhet të parashikojë të paktën dy seksione, të organizuara, përkatësisht, si seksioni i audituesve ligjorë dhe seksioni i shoqërive të auditimit.
4. Të dhënat e regjistrit i vihen në dispozicion Qendrës Kombëtare të Licencimit, në përputhje me legjislacionin e fushës.

Neni 28

Seksioni i audituesve ligjorë

Seksioni i audituesve ligjorë në regjistrin publik duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm, në lidhje me auditësin ligjor:

- a) emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit;
- a/1) sipas rastit, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- b) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit të shoqërisë audituese, që ka punësuar auditësin ligjor, ose me të cilën ai ka lidhje ortakërie apo një formë lidhjeje tjetër;
- c) të gjitha regjistrimet e tjera si auditues ligjor në vende të tjera, duke përfshirë emrin e Komitetit të Regjistrimit, si edhe të dhënat, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- ç) masat disiplinore, të dhëna në adresë të audituesit ligjor apo vendimet e mëparshme, të marra nga autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë pasur pasoja në regjistrë;
- d) shkarkimet e mëparshme.
- e) të përmbajë informacion lidhur me autoritetin kompetent:
 - (i) për regjistrimin në regjistrin publik;
 - (ii) për mbikëqyrjen e sigurimit të kontrollit të cilësisë së auditimit në zbatim të nenit 4 dhe nenit 39 të këtij ligji;
 - (iii) për kryerjen e investigimeve dhe marrjen e masave disiplinore dhe sanksioneve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në zbatim të Kreut VIII të këtij ligji.

Neni 29

Seksioni i shoqërive audituese

1. Seksioni i shoqërive audituese në regjistrin publik duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit;
- b) formën ligjore;
- c) informacione kontakti, të dhëna për administratorët kryesorë të subjektit apo për personin kryesor të kontaktit, si dhe adresën e faqes së internetit;
- ç) adresën e çdo zyre në Shqipëri;
- d) emrin dhe numrin e regjistrimit të të gjithë audituesve ligjorë si edhe të dhënat, nëse janë të miratuara për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, të punësuar nga kjo shoqëri auditimi dhe/ose të atyre që kanë lidhje ortakërie ose çdo lidhje tjetër me këtë

shoqëri;

- dh) emrat dhe adresat e biznesit të të gjithë ortakëve ose aksionarëve të shoqërisë;
 - e) emrat dhe adresat e biznesit të të gjithë anëtarëve të organeve të drejtimit ose administrimit;
 - ë) nëse është e mundur, anëtarësinë e rrjetit;
 - f) të gjitha regjistrimet e tjera si shoqëri audituese me autoritetet kompetente në vende të tjera, përfshirë Komitetin e Regjistrimit dhe numrin e datat e regjistrimit, si edhe të dhënat, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
 - g) vendimet e mëparshme, të marra nga autoritetet përgjegjëse, në adresë të shoqërisë audituese, të audituesve ligjorë të punësuar prej saj, të cilat kanë pasur pasoja në regjistër;
 - gj) rastet e mëparshme të zgjidhjes së parakohshme të kontratës për auditim ligjor.
- h) të përmbajë informacion lidhur autoritetin kompetent:
- (i) për regjistrimin në regjistrin publik;
 - (ii) (ii) për mbikëqyrjen e sigurimit e kontrollit të cilësisë së auditimit, në zbatim të neneve 4 e 39 të këtij ligji;
 - (iii) (iii) për kryerjen e investigimeve dhe marrjen e masave disiplinore e të sanksioneve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në zbatim të kreut VIII të këtij ligji.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregullat dhe procedurat për regjistrimin e përditësimit e informacionit në regjistrin publik për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit.

Neni 30

Përditësimi i informacionit të regjistrit publik

1. Audituesi ligjor dhe shoqëria audituese njoftojnë organizatën profesionale të audituesve ligjorë për ndryshimin e informacionit të detyrueshëm për publikim dhe të regjistruar në regjistrin publik sapo ndryshimi të ketë ndodhur.
2. Regjistri publik përditësohet menjëherë pas marrjes së njoftimit për ndryshimin e informacioneve të detyrueshme për publikim.

Neni 31

Gjuha e regjistrit publik

Regjistri publik mbahet dhe publikohet në gjuhën shqipe.

Seksioni IV

Etika profesionale, pavarësia dhe sekretet profesionale

Neni 32

Etika profesionale dhe papajtueshmëritë

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit zbatojnë parimet e etikës profesionale, ku përfshihen të paktën funksioni i tyre me interes publik, integriteti, objektiviteti, aftësia profesionale dhe kujdesi i duhur, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës të Profesionistëve Kontabël të publikuara nga FNK-ja, të përkthyer e të publikuara në shqip nga organizata profesionale e audituesve ligjorë jo më vonë se 12 muaj nga data e publikimit nga FNK-ja dhe të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja.
2. Audituesi ligjor mund ta ushtrojë profesionin:
 - a) në mënyrë individuale;
 - b) si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese.

- c) i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.
3. Funkzioni i audituesit ligjor është i papajtueshëm me çdo angazhim, si i punësuar, me përjashtim të:
- a) rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni;
 - b) ushtrimit të veprimtarisë së mësimdhënies;
 - c) pjesëmarrjes në seminare, konferenca apo veprimtari të ngjashme me to.

Neni 32/1 **Skepticizmi profesional**

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ushtrojë skepticizëm profesional gjatë kryerjes së një auditimi, duke pranuar mundësinë e një anomalie materiale, si pasojë e fakteve ose e sjelljeve, që tregojnë parregullsi, përfshirë mashtrimin ose gabimin, pavarësisht ndershmërisë dhe integritetit të treguar në të kaluarën nga drejtimi i subjektit të audituar dhe nga personat përgjegjës për drejtimin e tij.
2. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ushtrojë skepticizëm profesional në veçanti gjatë rishikimit të vlerësimeve të drejtuesve në lidhje me vlerat e drejta, zhvlerësimin e aktiveve, provizionet dhe fluksin e ardhshëm të mjeteve monetare që lidhen me aftësinë e subjektit për të vazhduar biznesin mbi bazën e parimit të vijimësisë.

Neni 33 **Konflikti i interesit**

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, duhet të jenë të pavarur nga personi juridik që auditohet dhe nuk duhet të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij entiteti. Pavarësia është e detyrueshme si për periudhën që mbulohet nga pasqyrat financiare që do të auditohen, ashtu edhe përgjatë periudhës së kryerjes së auditimit ligjor. 1/1. Kur kryen një auditim ligjor, një auditues ligjor ose një shoqëri audituese duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që pavarësia e tij nuk ndikohet nga ndonjë konflikt ekzistues ose i mundshëm interesi ose biznesi, ose nga ndonjë marrëdhënie tjetër e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, që përfshin audituesin ligjor ose shoqërinë audituese, që kryen auditimin, dhe, sipas rastit, rrjetin e tij, drejtuesit e tij, audituesit apo punonjësit e tij, çdo individ tjetër, shërbimet e të cilit janë në dispozicion ose nën kontrollin e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, ose çdo individ me lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me audituesin ligjor ose shoqërinë audituese nëpërmjet ushtrimit të kontrollit.
 2. Nëse pavarësia e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese cenohet nga kërcënime apo presione, që lidhen me konflikte interesi, si interesi personal, familjariteti, frikësimi apo mosbesimi, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrë masa mbrojtëse, me qëllim që të pakësojë ose të eliminojë efektin e këtyre rrethanave në kryerjen e auditimit.
 3. Nëse shkalla e kërcënimeve, në krahasim me masat mbrojtëse, është e tillë, që të rrezikohet pavarësia, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të heqë dorë nga auditimi ligjor.
 4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk do të pranojnë apo nuk do të kryejnë auditimin ligjor në rast se ekziston kërcënimi i vetërishikimit, i interesit vetjak, i familjaritetit dhe i frikësimit të krijuar gjatë marrëdhënies financiare, personale, tregtare, të punësimit apo të marrëdhënieve të tjera ndërmjet:
 - i. audituesit ligjor, shoqërisë së auditimit, rrjetit të shoqërisë së auditimit, cilitdo individ, në pozicion që mund të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në konkluzionet e auditimit ligjor; dhe
 - ii. njësisë ekonomike të audituar, ku, si rrjedhojë e kërcënimit, një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar, duke marrë në konsideratë të gjitha masat mbrojtëse të zbatuara, arrin në konkluzionin se pavarësia e audituesit ligjor ose e shoqërisë së auditimit është cenuar.
- 4.1 Audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit, krahas auditimit ligjor, mund të kryejë edhe

shërbimet e kontabilitetit, shërbimet e rishikimit e të dhënies së sigurisë ose shërbime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra për to në standardet dhe deklaratat e IAASB-së, kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në të gjitha këto raste duhet të zbatohen dispozitat e këtij ligji për ruajtjen e pavarësisë dhe shmangien e konfliktit të interesit.

- 4.2 Audituesi ligjor, shoqëria e auditimit, ortak kryesor i auditimit të tyre, punonjësit e tyre dhe cilido individ, shërbimet e të cilit janë në dispozicion apo nën kontrollin e audituesit ligjor ose të shoqërisë së auditimit, si dhe individët e përfshirë në procedurat e auditimit ligjor dhe individët e lidhur ngushtë me ta nuk duhet të zotërojnë apo të kenë interesa përfitimi materiale apo të angazhohen në transaksione të instrumenteve financiare të lëshuara, të garantuara apo të mbështetura në formë të tjera, nga cilado njësi ekonomike e audituar brenda fushës së auditimit ligjor. Përjashtim bëjnë 8 interesat e zotëruar në mënyrë të tërthortë nëpërmjet skemave të diversifikuara të investimit kolektiv, ku përfshihen edhe fondet e menaxhuara si fondet e pensionit apo sigurimi i jetës.
 5. Për shoqëritë e listuara në bursë, bankat ose shoqëritë e sigurimeve, audituesi ligjor ose shoqëria audituese mund të ofrojë, përveç auditimit, edhe shërbime të tjera, që nuk janë auditim ligjor, për sa kohë që një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e mirinformuar nuk arrin në përfundimin se shkelet pavarësia. Ankimimi, në rast shkeljeje, bëhet pranë bordit, i cili, pasi e shqyrton rastin, vendos për pretendimin e ngritur dhe urdhëron veprimet e mëtejshme.
 6. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese dokumentojnë në fletët e tyre të punës së auditimit të gjitha kërcënimet ose presionet e rëndësishme, që lidhen me pavarësinë e tyre, si dhe masat e marra për shmangien e tyre.
- 6/1. Në kuptim të pikës 6 të këtij neni, kërcënimet e rëndësishme mund të konsiderohen, por pa u kufizuar, rastet që lidhen me:
- a) interesat financiare;
 - b) huatë dhe garancitë;
 - c) marrëdhëniet e biznesit;
 - ç) marrëdhëniet familjare dhe personale;
 - d) punësimi të një subjekti auditimi;
 - dh) emërimi i përkohshëm i personelit;
 - e) shërbimet e ofruara kohët e fundit për subjektin e auditimit;
 - ë) mbajtjen e një pozicioni drejtues ose administrativ në njësinë ekonomike subjekt i auditimit;
 - f) ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato të sigurimit të cilësisë për një subjekt auditimi;
 - g) politikat e shpërblimit dhe vlerësimit;
 - gj) dhuratat dhe mikpritja;
 - h) çështje gjyqësore në proces ose të pretenduara për t'u ndërmarrë.
- 6/2. Personat ose shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 4/2 të këtij neni, nuk lejohen të marrin pjesë apo të ushtrojnë ndikim në rezultatin e auditimit ligjor të një njësie ekonomike, nëse:
- a) zotërojnë instrumente financiare të njësisë ekonomike të audituar, përveç kur janë interesa të zotëruar në mënyrë indirekte nëpërmjet skemave të diversifikuara kolektive të investimit;
 - b) zotërojnë instrumente financiare të njësisë ekonomike të lidhur me njësinë ekonomike të audituar, pronësia e së cilës mund të krijojë rrethana të konfliktit të interesit, përveç kur janë interesa të zotëruar në mënyrë indirekte nëpërmjet skemave të diversifikuara kolektive të investimit;
 - c) kanë pasur një marrëdhënie punësimi, biznesi ose marrëdhënie tjetër me njësinë ekonomike të audituar, që mund të krijojë rrethana të konfliktit të interesit me njësinë ekonomike që po auditohet, për periudhën që mbulohet nga pasqyrat financiare, që do të auditohen ashtu edhe përgjatë periudhës së kryerjes së auditimit ligjor.

- 6/3. Personat ose shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 4/2 të këtij neni, nuk lejohen të kërkojnë ose të pranojnë dhurata, donacione ose favore monetare dhe jomonetare nga njësi ekonomike e audituar apo cilado njësi ekonomike e lidhur me njësinë ekonomike të audituar, përveç rasteve kur një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do ta konsideronte vlerën e tyre si të papërfillshme ose të parëndësishme.
- 6/4. Nëse gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, njësi ekonomike e audituar blihet nga një njësi ekonomike tjetër, bashkohet me të ose blen një njësi ekonomike tjetër, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të identifikojë dhe të vlerësojë të gjithë interesat, marrëdhëniet aktuale ose të afërta, duke përfshirë shërbimet jo të auditimit të ofruar për atë njësi, të cilat, duke marrë parasysh edhe masat e mundshme mbrojtëse, mund të cenojnë pavarësinë dhe aftësinë e audituesit ligjor për të vijuar me auditimin ligjor pas datës efektive të bashkimit ose të blerjes. Brenda tre muajve nga njohja e bashkimit ose e blerjes, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të përfunduar çdo marrëdhënie aktuale ose interesë, që do të cenonte pavarësinë e tij. Gjithashtu, kur është e mundur, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ndërmarrë masa mbrojtëse për të minimizuar çdo kërcënim ndaj pavarësisë së tij, që rrjedh nga interesat dhe marrëdhëniet e mëparshme dhe aktuale me njësitë ekonomike të audituara ose me çdo njësi ekonomike tjetër të lidhur me të.
- 6/5. Audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit, që kryen auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese, pa kaluar një periudhë kohore prej të paktën një viti ose, në rastin e auditimit ligjor të 9 njësive ekonomike me interes publik, të paktën dy vjet nga përfundimi i emërimit të tij si auditues ligjor ose ortak kryesor i auditimit në angazhimin e auditimit, nuk lejohet që:
- a) të marrë ndonjë pozicion të rëndësishëm drejtimi në njësinë ekonomike të audituar;
 - b) të bëhet, sipas rastit, anëtar në komitetin e auditimit të njësisë ekonomike të audituar ose të një organi me funksione të barasvlershme me ato të një komiteti auditimi;
 - c) të bëhet anëtar joekzekutiv i organit administrativ ose i organit mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar.
- 6/6. Në çdo rast që punonjësit ose ortakët e një audituesi ligjor ose të një shoqërie audituese që kryejnë auditimin ligjor, si dhe çdo individ, shërbimet e të cilit janë në dispozicion ose nën kontrollin e këtij audituesi ligjor ose shoqërie audituese, regjistrohen si auditues ligjorë, ata nuk mund të mbajnë asnjë nga pozicionet e përmendura në pikën 6/5 të këtij neni, pa kaluar të paktën një vit nga përfundimi i përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në angazhimin e auditimit ligjor. Ky rregull nuk zbatohet për ortakët kryesorë të auditimit.
- 6/7. Kërkesat e këtij neni janë të zbatueshme edhe për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, që kryejnë shërbime të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
7. Tarifa e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi.
- 7/1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregulla të detajuara në zbatim të kërkesave të këtij neni dhe të kërkesave përkatëse të kodit të etikës në fuqi për auditimin dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në lidhje me përgatitjen për auditimin ligjor dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë, ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit, ndalimin e shërbimeve të joauditimit, parregullsitë e identifikuar në njësinë ekonomike kur kryhet auditimi ligjor dhe/ose dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë për një njësi ekonomike me interes publik.

Neni 34

Konfidencialiteti dhe sekreti profesional

1. Informacionet dhe dokumentet që përdoren ose mbi të cilat merret dijeni nga audituesi ligjor apo shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, mbrohen nga konfidencialiteti dhe sekreti profesional.
2. Rregullat e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së sekretit profesional, që lidhen me audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese, nuk përbëjnë pengesë për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, për zbatimin e standardeve dhe as bien ndesh me kërkesat ligjore të ligjeve të tjera, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë marrjen e këtyre informacioneve edhe kur ato mbrohen si konfidenciale dhe pjesë të sekretit profesional.
3. Në rast zëvendësimi të audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, pa përfunduar angazhimi i auditimit ligjor, audituesi ligjor apo shoqëria audituese e zëvendësuar duhet të vënë në dispozicion të pasardhësit të gjithë evidencën përkatëse të auditimit të mbledhur, në lidhje me atë entitet.
“Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregullat për transferimin e informacionit, në rastet e zëvendësimit të audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, pa përfunduar angazhimi i auditimit ligjor.
4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që ka ndërprerë angazhimet në një auditim të caktuar, ose një ish- auditues ligjor ose ish-shoqëri audituese, do të vazhdojnë t’u nënshtrohen dispozitave të pikave 1 e 2 të këtij neni, në lidhje me auditimet e kryera.

Neni 35

Pavarësia dhe objektiviteti

1. Pronarët, ortakët ose aksionarët e një shoqërie audituese, si dhe anëtarët e organeve të drejtimit apo administrimit të kësaj shoqërie ose të një shoqërie të lidhur me të, nuk lejohen të ndërhyjnë në kryerjen e një auditimi në çdo lloj mënyre, që rrezikon pavarësinë dhe objektivitetin e audituesit ligjor, që kryen auditimin.
2. Në funksion të ushtrimit të detyrës së vet, audituesi ligjor ka të drejtën:
 - a) të marrë dokumente dhe të bëjë verifikime;
 - b) të marrë deklarata nga drejtuesit e shoqërisë për çështjet që i nevojiten;
 - c) të heqë dorë apo të refuzojë kryerjen e një angazhimi.

Neni 36

Rregullat e Auditimit

1. Kur auditimi ligjor apo dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë kryhet nga një shoqëri audituese, kjo e fundit cakton të paktën një ortak kryesor të auditimit apo ortak kryesor të qëndrueshmërisë, i cili mund të jetë një nga ortakët kryesorë të auditimit. Shoqëria audituese duhet t’i sigurojë ortakut kryesor të auditimit dhe ortakut kryesor të qëndrueshmërisë burime të mjaftueshme dhe personel, që ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë të përshtatshme.
2. Në shërbimet e auditimit dhe të dhënies së sigurisë, sigurimi i cilësisë, i pavarësisë dhe i kompetencave duhet të jenë kriteret kryesore të përdorura nga shoqëria audituese gjatë përzgjedhjes së ortakut kryesor të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, të ortakut kryesor të qëndrueshmërisë. Ortakët kryesorë të auditimit dhe ortakët kryesorë të qëndrueshmërisë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në kryerjen e auditimit ligjor dhe në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
3. Audituesi ligjor u kushton kohë të mjaftueshme angazhimit të auditimit dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe duhet të caktojë burime të mjaftueshme që t’i mundësojnë kryerjen e detyrave në mënyrë të përshtatshme.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një regjistër për çdo shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për çdo pasojë të çdo shkeljeje, duke përfshirë masat e marra për adresimin e shkeljes dhe ndryshimet përkatëse në sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë. Ata do të përgatisin një raport vjetor, që përmban një pasqyrë të të gjitha masave të marra dhe që do të shpërndahet për komunikim të brendshëm. Në rast se audituesi ligjor 10 ose shoqëria audituese kërkon këshillim nga ekspertë të jashtëm gjatë një angazhimi auditimi, ai duhet të dokumentojë kërkesën për këshillim dhe këshillën e marrë nga eksperti i jashtëm.
5. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të mbajë një regjistër të klientit. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo klient auditimi:
 - a) emrin, adresën dhe vendndodhjen e biznesit;
 - b) në rastin e një shoqërie audituese, emrin e ortakut ose të ortakëve kryesorë të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, emrin e ortakut ose të ortakëve kryesorë të qëndrueshmërisë;
 - c) tarifat e aplikuara për auditimin ligjor, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe tarifat e aplikuara për shërbime të tjera për çdo periudhë raportuese.
6. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një dosje auditimi për çdo auditim ligjor dhe një dosje për çdo angazhim në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të dokumentojë në dosjet përkatëse të paktën vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë dhe fletët e punës, në përputhje me kërkesat përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të raportit të qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ruajë çdo të dhënë dhe dokument tjetër, që ka rëndësi në mbështetje të raportit të auditimit dhe për monitorimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, si dhe kërkesat e tjera të legjislacionit të zbatueshëm. Dosja e auditimit dhe ajo e raportimit të qëndrueshmërisë mbyllet e arkivohet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të raportit të auditimit dhe të raportit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme.
7. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të regjistrojë çdo ankesë të bërë me shkrim lidhur me realizimin e auditimeve ligjore të kryera apo të angazhimeve të dhënies së sigurisë në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë.
8. BMP-ja ka të drejtë të kërkojë informacionet e nevojshme nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Seksioni V

Standardet e punës dhe raportimi i auditimit

Neni 37

“Standardet e auditimit dhe raportimit të qëndrueshmërisë”

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese i kryejnë auditimet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.
 - 1.1. Fushëveprimi i auditimit ligjor nuk përfshin dhënien e garancive për vijimin e veprimtarisë së subjektit të audituar në të ardhmen ose efikasitetin apo efektivitetin e punës së kryer apo që do të kryejnë organet drejtuese të njësisë ekonomike.
2. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese e kryejnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në përputhje me standardet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja. Audituesit ligjorë ose shoqëritë e auditimit duhet të paraqesin rezultatet e raportimit të sigurimit të qëndrueshmërisë në një raport sigurie mbi raportimin e qëndrueshmërisë.
3. Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron përkthimin, përditësimin dhe publikimin në kohën e duhur të standardeve ekzistuese, të standardeve të reja ose atyre të rishikuara.

4. BMP-ja miraton rregulla dhe kërkesa të posaçme në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si edhe të raportit të dhënies së sigurisë për raportin vjetor e të konsoliduar të qëndrueshmërisë.

Neni 38

“Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësi”

1. Sistemi për sigurimin e cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin:

a) sigurimin e cilësisë, që organizohet brenda audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe është objekt i mbikëqyrjes publike;

b) sigurimin e cilësisë, që organizohet nga BMP-ja. BMP-ja mund të delegojë tek organizata profesionale e audituesve ligjorë kryerjen e kontrollit për sigurimin e cilësisë të njësive ekonomike, që nuk janë me interes publik. Kur BMP-ja i delegon organizatës këtë detyrë, e mbikëqyr këtë proces dhe mund të rimarrë kompetencat e deleguara, kur e vlerëson të nevojshme, rast pas rasti.

2. Sistemi i sigurimit të cilësisë, që organizohet nga BMP-ja, duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë dhe nga shoqëritë audituese;

b) financimi për sistemin e sigurimit të cilësisë duhet të jetë i sigurt dhe i lirë nga çdo ndikim i mundshëm dhe i papërshtatshëm nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese;

c) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të mbështetet në burime dhe në kapacitete të mjaftueshme;

ç) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të kenë arsimin përkatës profesional dhe përvojën e duhur në auditimin ligjor, raportimin financiar dhe, ku është e zbatueshme, në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të lidhura me të, të kombinuara me trajnime të posaçme për rishikimin e cilësisë në lidhje me auditimin ligjor.

3. BMP-ja miraton rregulloren dhe metodologjinë e detajuar për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit duhet të hartojnë e të zbatojnë politika dhe procedura të përshtatshme për organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë. Kërkesat për organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në rregulloren e përcaktuar në këtë pikë.

4. Sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, që kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nëpërmjet delegimit, organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit, të cilat kontrollohen.

5. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike me interes publik, si dhe të njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, janë objekt i kontrollit të cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike apo nga organizata profesionale e audituesve ligjorë në rastet kur kryerja e kontrollit të cilësisë i delegohet kësaj të fundit.”

Neni 39

Procedura e kontrollit të cilësisë

1. BMP organizon sistemin e sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të kontrolluar.
2. BMP-ja ngre një sistem efektiv të kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor. BMP-ja do të kryejë kontrole të sigurimit të cilësisë të shoqërive audituese, që kryejnë auditime ligjore mbi bazën e një analize të riskut dhe:
 - a) në rastin e shoqërive audituese, që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike me

interes publik të paktën një herë në tre vjet; dhe

b) në raste të tjera nga ato të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, dhe, ku është e zbatueshme për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë, të paktën një herë në gjashtë vjet.

3. Objekti i kontrolleve duhet të mbulojë të paktën:

a) një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të hartuar nga shoqëria audituese ose audituesi ligjor;

b) një testim të përshtatshëm për pajtueshmërinë e procedurave dhe rishikimin e dosjeve të angazhimit të auditimit, për të verifikuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë;

c) në kuadrin e gjetjeve të kontrollit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, një vlerësim të përmbajtjes së raportit vjetor më të fundit të transparencës të publikuar nga një shoqëri audituese ose audituesi ligjor.

4. Kontrolli duhet të mbulojë të paktën politikat dhe procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë audituese ose të audituesit ligjor për:

a) përputhshmërinë e shoqërisë audituese ose audituesit ligjor me standardet ndërkombëtare të zbatueshme të auditimit dhe të kontrollit të cilësisë, si dhe kërkesat mbi etikën dhe pavarësinë, dhe, kur është e zbatueshme, me standardet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) sasinë dhe cilësinë e burimeve të përdorura, duke përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e edukimit të vazhdueshëm profesional;

c) pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, për tarifën e zbatuar të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, tarifën për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Për qëllime të kontrollit të përputhshmërisë, dosjet e angazhimit të auditimit do të zgjidhen në bazë të një analize të rrezikut të dështimit për të kryer një auditim ligjor në mënyrë të përshtatshme.

BMP-ja, gjithashtu, do të rishikojë periodikisht metodologjitë e auditimit të përdorura nga shoqëritë audituese për të kryer auditimet ligjore. Përveç kontrolleve të përcaktuara në këtë pikë, BMP-ja do të ketë kompetencën për të kryer kontrolle të tjera sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin përkatës të fushave të tjera.

5. BMP-ja vendos një afat kohor të arsyeshëm për zbatimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Kjo periudhë nuk duhet të kalojë 12 muaj në rastin e rekomandimeve për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë të shoqërisë audituese.

6. Nëse rekomandimet dhe afatet e caktuara të parashikuara në pikën 5 të këtij neni nuk ndiqen për zbatim, audituesi ligjor ose shoqëria audituese do t’u nënshtrohet masave disiplinore të parashikuara në nenin 55 të këtij ligji.

7. Afati i përfundimit të procedurave të kontrollit të cilësisë është deri në 6 muaj nga data e njoftimit për fillimin e procedurave të kontrollit.

8. Afati, sipas pikës 7 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të BMP-së jo më shumë se 6 muaj në rast se kërkohen procedura të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

9. Në të gjitha rastet kur audituesi ligjor/shoqëria audituese e përzgjedhur për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit, do të jenë subjekt i masave disiplinore të përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji.

10. BMP miraton rregulloren për procedurat e kontrollit për sigurimin e cilësisë.

Neni 40

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, gjatë ushtrimit të auditimit, ka përgjegjësinë dhe

detyrimin e zhdëmtimit të pasojave financiare, që vijnë drejtpërdrejt nga gabimi apo faji i tij në punë. Pa iu shmangur kësaj përgjegjësie, audituesi ligjor apo shoqëria audituese, nga njëra anë dhe klienti i tyre, nga ana tjetër, mund të bien dakord për kufizimin e kësaj përgjegjësie, deri në një shumë të paracaktuar, në letrën e tyre të angazhimit.

KREU V
AUDITIMI LIGJOR I PASQYRAVE FINANCIARE,
EMËRIMI DHE SHKARKIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE SHOQËRISË
AUDITUESE

Neni 41

Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

1. Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:
 - a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;
 - b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:
 - i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;
 - ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;
 - iii. ka, mesatarisht, të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Neni 42

Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese emërohet çdo vit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve për shoqëritë aksionare, nga asambleja e ortakëve për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ose nga ndonjë organ tjetër i ngarkuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit specifik në fuqi, me të drejtë riemërimi. Kohëzgjatja totale e emërimit në angazhimin e auditimit nuk do të kalojë periudhën 10-vjeçare, si për audituesin ligjor ose shoqërinë audituese, ashtu edhe për këto në kombinim. Me kalimin e kohëzgjatjes maksimale të emërimit në angazhimet e auditimit, as audituesi ligjor, as shoqëria audituese dhe, kur është e zbatueshme, ndonjë anëtar i rrjeteve të tyre nuk do të ndërmarrin auditimin ligjor të së njëjtës njësi ekonomike me interes publik brenda periudhës katërvjeçare në vijim. Për njësitë ekonomike jo me interes publik do të zbatohet periudha trivjeçare në vijim.

Ndalohet çdo klauzolë kontraktuale dhe/ose statutore, që kufizon emërimin nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve dhe/ose nga organe të tjera të njësive ekonomike të audituara, për disa kategori ose lista audituesish ose shoqërish audituese në lidhje me emërimin e një audituesi ligjor ose shoqërie audituese të caktuar për të kryer auditimin ligjor apo dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të asaj njësie ekonomike. Çdo klauzolë e tillë në kontratat ekzistuese do të konsiderohet e pavlefshme.

2. Ortaku kryesor i auditimit në një shoqëri audituese, që është audituesi ligjor, përgjegjës për kryerjen e angazhimit të auditimit në emër të shoqërisë audituese, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e fillimit si auditues ligjor. Ai mund të marrë pjesë sërish në auditimin e së njëjtës njësi ekonomike pas kalimit të një periudhe prej të paktën 3 vjetësh nga

- zëvendësimi i tij, me kusht që periudha kohore e përgjithshme e angazhimit të mos kalojë 10 vjet.
3. Autoritetet mbikëqyrëse të tregjeve të rregulluara me ligj të veçantë mund të parashikojnë kritere shtesë, të cilat duhet të plotësohen nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese, që do të kryejnë auditimin e njësive ekonomike të mbikëqyrura prej tyre.
 4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin e auditimit nëse vendimi i emërimit i përcaktuar në këtë nen nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe kushtet e tjera të kryerjes së angazhimit të auditimit të përcaktuara në këtë ligj.
 5. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij neni nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit, do të zbatohen masat disiplinore në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.
 6. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij neni nga organi administrativ ose drejtuesi i një njësie ekonomike me interes publik, do të zbatohen masat disiplinore të parashikuara në nenin 55 të këtij ligji.

Neni 43

Auditimi ligjor i pasqyrave financiare të konsoliduara

Në rastin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara të një grupi sipërmarrjesh, audituesi ligjor i grupit:

- a) mban përgjegjësi të plotë për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e auditimit;
- b) kryen kontroll të auditimit, të bërë nga audituesit ligjorë të tjerë, si edhe në një juridiksion tjetër, për qëllimet e auditimit të grupit.

Neni 43/1

Raporti i auditimit

Kur shoqëria e auditimit kryen auditim ligjor, raporti i auditimit do të nënshkruhet dhe datohet nga, të paktën, njëri prej audituesve ligjorë që kryejnë auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese.

Neni 44

Shkarkimi dhe dorëheqja

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese mund të shkarkohet përpara përfundimit të auditimit vetëm kur ka arsye të mjaftueshme. Papajtueshmëria e mendimeve për trajtimet kontabël, raportimin financiar ose procedurat e auditimit nuk përbëjnë arsye të vlefshme për shkarkim.
2. Bordi i mbikëqyrjes publike është autoriteti i shqyrtimit të ankesave për rastet e shkarkimit të audituesit ligjor apo shoqërisë audituese nga shoqëria tregtare, përpara përfundimit të angazhimit të auditimit ligjor.
3. Shoqëria tregtare, subjekt i auditimit të pasqyrave financiare dhe audituesi ligjor apo shoqëria audituese, subjekt i një kërkesë për shkarkim, në mënyrë të pavarur, informojnë organizatën profesionale të audituesve ligjorë dhe japin shpjegime të mjaftueshme për arsyet. Për çdo rast të paraqitur, organizata profesionale i përgatit një relacion bordit, për shkarkimin gjatë kohës së angazhimit të auditimit ligjor.
4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, në rast dorëheqjeje nga detyra e auditimit, njofton, me shkrim, organizatën profesionale për motivet e dorëheqjes. Në këtë rast, funksionin dhe përgjegjësinë e ndërmjetësimit apo shqyrtimit të konfliktit për rastin e ka kryetari i këshillit drejtues të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

KREU VI

DISPOZITA TË POSAÇME PËR AUDITIMIN LIGJOR TË NJËSIVE EKONOMIKE ME INTERES PUBLIK

Neni 45

Raporti për transparencën

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik, brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar, publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën, ku përfshihen të paktën:

- a) përshkrimi i strukturës ligjore dhe i pronësisë;
- b) përshkrimi i rrjetit, kur shoqëria e auditimit i përket një rrjeti;
- c) përshkrimi i strukturës drejtuese të shoqërisë së auditimit;
- ç) përshkrimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë së auditimit;
- d) informacioni për kryerjen e kontrollit të fundit të cilësisë;
- dh) lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit;
- e) deklaratat e praktikave të pavarësisë së shoqërisë audituese;
- ë) deklarata për politikën e ndjekur nga shoqëria audituese, për kualifikimin e vijueshëm profesional të audituesve ligjorë ;
- f) informacioni financiar, në të cilin tregohet rëndësia e shoqërisë së auditimit, përfshirë qarkullimin, gjithsej, të ndarë në të ardhurat nga tarifat e auditimit ligjor, nga tarifat për shërbimet e tjera, nga këshillimet tatimore dhe shërbime të tjera joauditimi.
- g) informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit.

Neni 46

Komiteti i auditimit të njësive ekonomike me interes publik

1. Çdo njësi ekonomike me interes publik duhet të ketë një komitet auditimi. Komiteti i auditimit duhet të jetë ose një komitet i pavarur, ose një komitet i organit administrativ, ose i organit mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar.
2. Komiteti është i përbërë nga:
 - a) anëtarë joekzekutivë të organit administrativ; dhe/ose
 - b) anëtarë të organit mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar; dhe/ose
 - c) anëtarë të emëruar nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve të njësisë ekonomike të audituar, ose nga një organ ekuivalent me të për subjektet pa aksionarë/ortakë.
3. Të paktën një anëtar i komitetit të auditimit duhet të ketë aftësi profesionale në kontabilitet dhe/ose auditim. Anëtarët e komitetit në tërësi duhet të kenë njohuri të lidhura me sektorin në të cilin operon njësia ekonomike e audituar. Shumica e anëtarëve të komitetit të auditimit duhet të jenë të pavarur nga njësia ekonomike e audituar.
4. Kryetari i komitetit të auditimit emërohet nga anëtarët e tij ose nga organi mbikëqyrës i njësisë ekonomike të audituar dhe është i pavarur nga njësia ekonomike e audituar. Kryetari i komitetit të auditimit mund të zgjidhet edhe nga asambleja e përgjithshme e ortakëve të njësive ekonomike me interes publik çdo vit.
5. Pa cenuar përgjegjësinë e administratorit të shoqërisë, të anëtarëve të organeve administrative ose mbikëqyrëse, ose të anëtarëve të tjerë të emëruar nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve të njësisë ekonomike të audituar, komiteti i auditimit do të ketë, ndër të tjera, detyrat e mëposhtme:
 - a) informimin e administratorit të shoqërisë ose të anëtarëve të organit administrativ

ose mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar mbi rezultatin e auditimit ligjor dhe, ku është e zbatueshme, mbi rezultatet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe dhënien e shpjegimeve se si auditimi ligjor dhe dhënia e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë kontribuon në integritetin e raportimit financiar dhe qëndrueshmërisë, dhe rolit të komitetit të auditimit në këtë proces;

b) monitorimin e procesit të raportimit financiar dhe, ku është e zbatueshme, të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe paraqitjen e rekomandimeve apo të propozimeve për të siguruar integritetin e tyre;

c) monitorimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe sistemeve të menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes dhe, sipas rastit, të auditimit të brendshëm, në lidhje me raportimin financiar dhe, ku është e zbatueshme, të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, të njësisë ekonomike të audituar, pa cenuar pavarësinë e tij;

ç) monitorimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara dhe, ku është e zbatueshme, dhënien e sigurisë për raportimin vjetor e të konsoliduar të qëndrueshmërisë, në veçanti, të kryerjes së angazhimit të auditimit ligjor, duke marrë parasysh çdo gjetje dhe konkluzion të kontroleve për sigurimin e cilësisë të realizuara nga BMP-ja; 15

d) kontrollin e monitorimin e pavarësisë së shoqërive audituese në përputhje me kërkesat përkatëse të kodit të etikës dhe të këtij ligji dhe, në veçanti, përshtatshmërisë së ofrimit të shërbimeve joaudituese për njësinë ekonomike të audituar;

dh) kryerjen e procedurës së përzgjedhjes së shoqërisë audituese dhe të rekomandojë shoqërinë audituese, që do të emërohet nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve, tek anëtarët e organit administrativ ose mbikëqyrës në përputhje me kërkesat e zbatueshme, sipas normave në fuqi.

e) audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit, apo sipas rastit audituesit të grupit, duhet t'i komunikojë komitetit të auditimit të njësisë ekonomike të audituar për rrethanat e kërcënimit të pavarësisë dhe masat e marra për zbutjen e këtyre kërcënimeve në rastin kur totali i tarifës së paguar nga njësi ekonomike me interes publik çdo vit, për tre vjetët financiarë të fundit të njëpasnjëshëm, është më shumë se 15% i totalit të tarifave të faturuara për shërbimet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të kryer prej tyre për secilin vit të këtyre viteve.

Komiteti i auditimit shqyrton nëse angazhimi i auditimit duhet t'i nënshtrohet një rishikimi të kontrollit të cilësisë së angazhimit nga një auditues tjetër ligjor ose shoqëri auditimi përpara lëshimit të raportit të auditimit.

Kur tarifat e përfituara nga audituesi ligjor, shoqëria e auditimit, apo sipas rastit audituesit të grupit nga kjo njësi ekonomike me interes publik, vazhdojnë të kalojnë 15% të tarifave totale të auditimit të përfituara prej tyre, komiteti i auditimit vendos nëse audituesi ligjor, shoqëria audituese ose audituesi i grupit, i njësisë ekonomike ose grupi i njësive ekonomike mund të vazhdojë të kryejë auditimin ligjor për një periudhë shtesë, periudhë e cila në asnjë rast nuk duhet të kalojë dy vjet.

6. Shoqëria audituese raporton çdo vit në komitetin e auditimit për çështjet kryesore që dalin nga auditimi ligjor dhe ndihmon komitetin e auditimit për kryerjen e detyrave të tij.
7. Komiteti i auditimit në njësitë ekonomike me interes publik, që veprojnë në fushën e kreditimit dhe të sigurimeve, përveç kërkesave të këtij ligji, duhet të zbatojnë edhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e fushave të tjera përkatëse.
8. BMP përcakton rregulla të detajuara në lidhje me raportimin në komitetin e auditimit.

Neni 46/1

Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit

1. Para lëshimit të raportit të auditimit dhe raportit shtesë për komitetin e auditimit duhet të

realizohet një rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit për të vlerësuar nëse audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit kanë formuar në mënyrë të arsyeshme opinionin dhe konkluzionet e shprehura në draftin e këtyre raporteve.

2. Rishikimi do të kryhet nga një rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit. Rishikuesi duhet të jetë një auditues ligjor, i cili nuk është i përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor, subjekt i rishikimit.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, kur auditimi ligjor kryhet nga një shoqëri audituese dhe të gjithë audituesit ligjorë kanë qenë të përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor ose kur auditimi ligjor është kryer nga një auditues ligjor, i cili nuk është ortak ose punonjës i një shoqërie audituese, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrë masat që rishikimi të kryhet nga një tjetër auditues ligjor. Për qëllimet e këtij neni, dhënia e dokumentacionit apo e informacionit rishikuesit të pavarur nuk përbën shkelje të dispozitave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekretit profesional. Dokumentacioni apo informacioni që i ofrohet rishikuesit për qëllimet e këtij neni do t'i nënshtrohet sekretit profesional.

4. Gjatë kryerjes së rishikimit, rishikuesi duhet të paktën të dokumentojë të dhënat për sa më poshtë:

a) informacionin e siguruar, verbalisht dhe me shkrim, nga audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit në mbështetje të gjykimeve të rëndësishme, gjetjet kryesore nga kryerja e procedurave të auditimit, si dhe konkluzionet e nxjerra nga këto gjetje, pavarësisht nëse kërkohet apo jo nga rishikuesi;

b) opinionin e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit, ashtu siç shprehen në draftin e raporteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

5. Rishikimi duhet të vlerësojë së paku elementet e mëposhtme:

a) pavarësinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese nga njësia ekonomike e audituar; b) rreziqet e rëndësishme që lidhen me auditimin ligjor dhe që audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit ka identifikuar gjatë kryerjes së auditimit dhe masat që ai ka marrë për t'i adresuar në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe;

c) gjykimin profesional të audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit, veçanërisht në lidhje me nivelin e materialitetit dhe rreziqet e rëndësishme të përcaktuara në shkronjën “b” të kësaj pike;

ç) çdo kërkesë për këshillim drejtuar ekspertëve të jashtëm dhe zbatimin e këtyre këshillave;

d) natyrën dhe përhapjen e anomalive, të korrigjuara ose jo, të identifikuara në pasqyrat financiare gjatë kryerjes së auditimit;

dh) çështjet e diskutuara me komitetin e auditimit dhe organet drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të njësisë ekonomike të audituar;

e) çështjet e diskutuara me autoritetet kompetente dhe, sipas rastit, me palë të treta;

ë) nëse dokumentacioni dhe informacionet e dosjes së auditimit, të përzgjedhura nga rishikuesi, mbështesin opinionin e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit të shprehur në draftin e raporteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

6. Rishikuesi i diskuton rezultatet e rishikimit me audituesin ligjor ose ortakun kryesor të auditimit. Shoqëria audituese duhet të përcaktojë procedurat për mënyrën e zgjidhjes së çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet ortakut kryesor të auditimit dhe rishikuesit.

7. Shoqëria audituese dhe rishikuesi duhet të dokumentojnë rezultatet e rishikimit së bashku me gjykimin profesional në bazë të këtyre rezultateve.

Neni 47 **Pavarësia**

1. Përveç detyrimeve të tjera, të parashikuara në këtë ligj, audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike me interes publik:

a) konfirmon çdo vit pavarësinë e vet nga subjekti i audituar;

b) paraqet çdo vit pranë komitetit të auditimit shërbimet e tjera shtesë, që i ka ofruar subjektit të audituar;

c) diskuton me komitetin e auditimit mbi kërcënimet për pavarësinë dhe masat

mbrojtëse të sigurisë, të marra kundrejt tyre.

2. Audituesi ligjor ose ortak kryesor, që kryen auditimin ligjor në emër të një shoqërie auditimi, nuk ka të drejtë të pranojë ose të kryejë funksione të rëndësishme drejtimi në njësinë ekonomike të audituar pa kaluar një periudhë kohe prej, të paktën, një viti, ose, në rastin e auditimit të njësisë ekonomike me interes publik, të paktën, 2 vitesh, nga koha kur ka dhënë dorëheqjen si auditues ligjor ose ortak kryesor nga angazhimi i auditimit.

KREU VII

KONTABILISTI I MIRATUAR DHE SHOQËRIA E KONTABILITETIT

Neni 48

Kontabilisti i miratuar dhe shoqëria e kontabilitetit

1. Shërbimet e kontabilitetit janë përgjegjësi e drejtimit të shoqërive tregtare dhe të subjekteve të tjera, që detyrohen nga ligji ta marrin këtë shërbim.
2. Përveçse përmes punonjësve të angazhuar me një kontratë punësimi, të hartuar në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, shërbimet e kontabilitetit mund të realizohen edhe nga persona fizikë, të kualifikuar si kontabilistë të miratuar, ose nga shoqëritë e kontabilitetit, që angazhojnë kontabilistë të miratuar, të cilët janë testuar nga Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale, sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj. Kontabilistët e miratuar mund të kryejnë edhe shërbime të tjera, që nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
3. Shoqëritë e kontabilitetit organizohen si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin e fushës dhe duhet të administrohen nga një ose më shumë persona, të cilët janë pajisur me certifikatën e kontabilistit të miratuar.
4. Përveç dispozitave të parashikuara në këtë kre, anëtarët e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar u nënshtrohen edhe rregullave të statutit apo rregullave të tjera të brendshme. Rregullat e brendshme të organizatës profesionale të kontabilistëve të miratuar miratohen nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve dhe parashikojnë rregulla për vendosjen dhe zbatimin e masave disiplinore.

Neni 49

Kriteret e përzgjedhjes dhe të regjistrimit të kontabilistit të miratuar

Titulli profesional i kontabilistit të miratuar i jepet personit fizik që dëshmon se plotëson këto kriteret:

- a) është pajisur me një diplomë të shkollës së lartë, sipas parashikimit të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji;
- b) ka, të paktën, tre vjet përvojë profesionale në fushën e kontabilitetit, të financës, kontrollit financiar dhe në fusha të ngjashme;
- c) ka kryer kursin e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të organizuar ose të monitoruar nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar, në të cilën individi dëshiron të anëtarësohet;
- ç) kalon me sukses provimet e aftësisë profesionale.

Neni 50

Provimi i aftësive profesionale

1. Për të fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, i nënshtrohen provimit përfundimtar të aftësive profesionale vetëm për testet, të cilave u nënshtrohen edhe audituesit ligjorë, të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 18, të këtij ligji.
2. Statuti i organizatës profesionale të kontabilistëve mund të parashikojë edhe provime të

tjera, si kusht për anëtarësimin në organizatën respektive.

Neni 51

E drejta e ushtrimit të profesionit

1. Profesioni i kontabilistit të miratuar nga personat, që kanë kaluar provimin e aftësisë profesionale, ushtrohet vetëm pas anëtarësimit të tyre në një organizatë profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohur nga bordi, e cila angazhohet për ndjekjen e standardeve profesionale, cilësisht të larta dhe për zbatimin e një kodi etike, që është në pajtim me kodin e etikës të IFAC-së.
2. Organizmat profesionalë të kontabilistëve të miratuar mbajnë dhe publikojnë regjistrin e anëtarëve, i cili ndahet në katër seksionet e mëposhtme:
 - a) anëtarë, persona fizikë aktivë;
 - b) anëtarë, persona fizikë joaktivë;
 - c) kandidatë;
 - ç) shoqëri të kontabilistëve të miratuar.
3. Organizmat hartojnë rregullat e tyre të brendshme dhe statutin, i cili është subjekt i miratimit nga bordi.

Neni 52

Kualifikimi i vijueshëm profesional

1. Dispozitat e këtij ligji, të parashikuara për kualifikimin e vijueshëm profesional të audituesve ligjorë duhet të zbatohen nga organizmat profesionalë edhe për kontabilistët e miratuar, për aq sa i takon fushës, për të cilën ata janë testuar, në çastin e hyrjes në profesion.
2. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar hartojnë rregullat e brendshme për kualifikimin e vijueshëm profesional, si dhe rregullat për regjistrimin e çregjistrimin e anëtarëve.

Neni 53

Regjistrimi i kontabilistëve të miratuar

1. Regjistrimi i kontabilistëve të miratuar dhe i shoqërive të kontabilitetit, si dhe mbajtja e regjistrit e përditësimi i tij bëhen nga vetë organizmat profesionalë të kontabilistëve të miratuar.
2. Regjistri mbahet në format elektronik dhe është i hapur për personat e interesuar.

KREU VIII

SHKELJET DHE SANKSIONET

Neni 54

Fusha e zbatimit

Ky kre zbatohet vetëm për anëtarët e organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe për vetë organizatën profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 55

Shkeljet dhe masat disiplinore

1. BMP-ja është përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv dhe proporcional të investigimeve dhe të sanksioneve, me qëllim zbulimin, korrigjimin e parandalimin e mangësive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
2. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me

- kontrollin e sigurimit të cilësisë, BMP-ja ka të drejtë të marrë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese një ose disa nga llojet e masave disiplinore të mëposhtme:
- a) vërejtje, nëpërmjet së cilës personit fizik ose personit juridik përgjegjës për shkeljen i kërkohet të ndërpresë shkeljen dhe të mos e përsërisë atë në të ardhmen;
 - b) dënim me gjobë në masën nga 0,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse;
 - c) pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon:
 - i. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose partnerin kryesor të auditimit të kryejë auditim ligjor dhe/ose të nënshkruajë raporte të auditimit ligjor; apo
 - ii. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose ortakun kryesor të qëndrueshmërisë të kryejë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe/ose nënshkrimin e raportit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
 - ç) pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon anëtarët e një shoqërie auditimi apo të një organi administrativ ose drejtues të një njësie ekonomike me interes publik të ushtrojnë funksione në shoqëritë audituese ose në njësitë ekonomike me interes publik.
 - d) heqja e së drejtës për ushtrimin e profesionit, çregjistrimi i audituesit ligjor nga regjistri publik dhe humbja e së drejtës së regjistrimit.
3. Krahas masave disiplinore të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, BMP-ja ka të drejtë të deklarojë se raporti i auditimit apo raporti i dhënies së sigurisë për raportimin nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe të rregulloreve në zbatim të tij.
4. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 2, shkronja “a”, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore që përfshihen në llojet e shkeljeve për të cilat jepen masat disiplinore të shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d” të kësaj pike dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie, e cila mund të përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore. Këto masa jepen kur audituesi ose shoqëria e auditimit ka bërë deklaram vullnetar përpara fillimit të procesit të investigimit apo kontrollit të cilësisë.
5. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 2, shkronja “b”, të këtij neni zbatohet si më poshtë:
- a) do të zbatohet sanksioni 0,5% deri në 1,5% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:
 - i. nuk zbaton kërkesat e nenit 44, pikat 1 dhe/ose 4;
 - ii. nuk kryen njoftimin në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;
 - iii. nuk zbaton kërkesat e nenit 25 të këtij ligji dhe të rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional;
 - iv. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 45 të këtij ligji;
 - v. nuk dorëzon brenda afateve informacionin e parashikuar në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë.
 - b) do të zbatohet sanksioni 1,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:
 - i. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji;
 - ii. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në lidhje me etikën profesionale, pavarësinë dhe sekretin profesional të parashikuara në seksionin IV të kreut IV dhe në nenin 47 të këtij ligji, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - iii. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë të audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese dhe/ose të rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - iv. në rastet kur personat që kanë kaluar testimet e aftësive profesionale ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor pa qenë të regjistruar më parë në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë;
 - v. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në lidhje me standardet e

- rregullat e punës dhe raportimin e auditimit të parashikuara në seksionin V të kreut IV të këtij ligji dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.
6. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 2, shkronja “c”, do të zbatohet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë konstatohet një ose disa prej shkeljeve të mëposhtme:
 - a) rezultatet e auditimit ligjor të paraqitura në raportin e auditimit nuk mbështeten në procedurat e punës dhe në evidencën e auditimit, në zbatim të kërkesave përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit;
 - b) janë kryer në më shumë se 1/3 e dosjeve të angazhimeve të auditimit ligjor të paktën një nga shkeljet e sanksionueshme në pikën 5, shkronja “b” të këtij neni;
 - c) në përfundim të kontrollit pasues vlerësohet se nga audituesi ligjor apo shoqëria audituese nuk janë zbatuar afatet e vendosura nga BMP-ja dhe rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë;
 - ç) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP-ja;
 - d) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e procedurës të investigimit nga BMP-ja;
 - dh) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë.
 7. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 2, shkronja “ç”, të këtij neni jepet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë konstatohen shkelje të nenit 42 të këtij ligji.
 8. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 2, shkronja “d”, të këtij neni jepet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë konstatohet se:
 - a) janë përmbushur kushtet e zbatimit të nenit 24 të këtij ligji;
 - b) janë përsëritur më shumë se dy herë (recetivizëm) shkelje të parashikuara në pikën 6 të këtij neni;
 - c) audituesit ligjorë ose shoqëria e auditimit përfshihen në shërbime të dhënies së sigurisë për pasqyrat financiare dhe/ose raportimit të qëndrueshmërisë të përgatitura për qëllimet e klientit, kur verifikohet se këto të fundit janë informale të hartuara jo në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
 9. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton rregulloren për procedurat administrative të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, si dhe përcaktimin e masës së gjobës brenda kufijve respektivë të nenit 55, pika 5, të këtij nenin.
 10. Afati i përfundimit të procedurave të investigimit është deri në 6 muaj nga data e vendimit për fillimin e procedurës të investigimit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të BMP-së, jo më shumë se 6 muaj në rast se kërkohen investigime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.”.

Neni 55/1

Publikimi i masave disiplinore

1. Përveç publikimit në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë dhe Shoqërive Audituese, masat disiplinore do të publikohen gjithashtu edhe në faqen zyrtare të BMP-së, shoqëruar me informacion mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit ose të personit juridik për të cilin është vendosur sanksioni, pasi të gjitha të drejtat e apelimit, të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji, të jenë shteruar ose të ketë përfunduar afati i ankimit, menjëherë pasi audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit janë njoftuar për atë vendim. Akti disiplinor duhet të përmbajë edhe dispozitat për mënyrën e publikimit.
2. BMP-ja dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë, referuar sanksioneve që kanë qenë

objekt ankimi, në përputhje me nenin 57/1 të këtij ligji, publikojnë, sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të arsyetuar që të jetë e mundur, informacione lidhur me statusin e rezultatin e çdo ankimi.

3. BMP-ja dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë mund të publikojnë sanksionet e vendosura në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:
 - a) në rastet kur sanksioni është vendosur ndaj një individi dhe publikimi i të dhënave personale rezulton të jetë joproporcional nga një vlerësim paraprak i detyrueshëm i proporcionalitetit të këtij publikimi;
 - b) kur publikimi vë në rrezik stabilitetin e tregjeve financiare ose procesin hetimor në vazhdim;
 - c) kur publikimi shkakton dëme joproporcionale (më të mëdha se shkelja) për institucionet ose individët e përfshirë
4. BMP-ja duhet të sigurojë që çdo publikim në përputhje me pikën 1 të këtij neni të bëhet brenda një kohe të arsyeshme dhe të ruhet në faqen e tyre zyrtare të internetit për të paktën pesë vjet, pasi të jenë shteruar ose të kenë kaluar të gjitha të drejtat apo afatet e ankimit të parashikuara në nenin 57/1 të këtij ligji.
5. BMP-ja publikon në faqen e saj zyrtare sanksionet administrative të dhëna sipas nenit 55/2 të këtij ligji, të cilat do të ruhen në këtë faqe për një periudhë 1-vjeçare që nga data e publikimit.
6. Publikimi i sanksioneve, i masave disiplinore dhe i çdo deklarate publike duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore, në veçanti, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 55/2

Përgjegjësia administrative për strukturat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë

1. Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur, që mbajnë pozicione në strukturat drejtuese të tij janë përgjegjës për shkeljet administrative ose disiplinore të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. BMP-ja ka të drejtë të vendosë llojet e sanksioneve administrative:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) gjobë administrative që varion nga 1 deri në 10 paga mesatare kombëtare bruto, sipas përditësimit të raporteve statistikore të INSTAT-it, për vitin në të cilën është vendosur penalteti;
 - c) pezullim i përkohshëm nga detyra për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit. Në rast pezullimi të drejtorit ekzekutiv të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, emërohet një drejtor i përkohshëm në përputhje me statutin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.Këto sanksione do të zbatohen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes.
2. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni.
3. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “b”, të këtij neni jepet në rastet kur:
 - a) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 12 të këtij ligji;
 - b) nuk është zbatuar neni 15 i këtij ligji;
 - c) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenet 10, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji;
 - ç) nuk është zbatuar pika 7 e nenit 17 të këtij ligji;
 - d) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenet 19, 20, 21, 22 dhe 23 të këtij ligji;
 - dh) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në seksionin III të kreut

IV;

- e) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji;
 - ë) nuk është zbatuar pika 1 e nenit 32 të këtij ligji;
4. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “c”, të këtij neni jepet në rastet kur të paktën një prej shkeljeve të sanksionuara sipas pikës 3 të këtij neni përsëritet.

Neni 56 shfuqizohet

Neni 57

Kompetenca në marrjen e masave disiplinore

1. Kompetenca e marrjes së masave disiplinore i takon bordit të mbikëqyrjes publike.
2. Komisioni i disiplinës, i cili funksionon pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, apo çdo person, i cili vihet në dijeni të rasteve, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, ka të drejtën t’i drejtohet bordit të mbikëqyrjes publike, duke i vënë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës që vërteton shkeljen.

Neni 57/1

E drejta e ankimit

Kundër akteve administrative të nxjerra nga BMP-ja mund të ushtrohet ankim drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 57/2

Shlyerja e gjobave

Në rastin e masës disiplinore me gjobë, audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit duhet të shlyejë, brenda 2 muajve, masën e gjobës. Në të kundërt, zbatohet masa disiplinore e pezullimit të përkohshëm, deri në çastin e shlyerjes së saj.

Neni 57/3

E drejta e rishikimit

Çdo palë e përfshirë në një procedurë ankimi mund t’i kërkojë BMP-së brenda 30 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të BMP-së në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara. BMP-ja shqyrton kërkesën dhe vendos jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 58 shfuqizohet.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 59

Dispozita kalimtare

(Ndryshuar me nenin 32 të Ligjit 126/2024)

1. Përfshihen nga kërkesat e neneve 15, pika 1, shkronja “c”, 18, pika 6/1, të këtij ligji të gjithë audituesit ligjorë të regjistruar apo që kanë fituar titullin “Auditues ligjor” në datën e

hyrjes në fuqi të këtij ligji, që do të angazhohen për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

2. Kandidatët që janë në proces për të fituar titullin “Auditues ligjor” pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të plotësojnë kërkesat e neneve 15 e 18, pika 6/1, të këtij ligji brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Audituesit ligjorë, që do të angazhohen në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, do të sigurojnë njohuritë e domosdoshme në disiplinat e përcaktuara në pikën 6/1 të nenit 18 të këtij ligji nëpërmjet edukimit të vijueshëm profesional.
4. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit japin siguri mbi raportin jofinanciar, të hartuar nga njësitë ekonomike në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të shpallura të detyrueshme për zbatim për 3 periudha raportuese vijuese duke filluar nga periudha e raportimit për vitin 2024.
5. Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit sipas këtij ligji, nuk është e detyrueshme deri për periudhën e raportimit për vitin 2027.

Neni 60

Hartimi i akteve nënligjore

(Ndryshuar me nenin 33 të Ligjit 126/2024)

Ngarkohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj, që janë kompetencë e tij.

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Elisa SPIROPALI

Miratur në datën 19.12.2024

Botuar në Fletoren Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 7, Datë. 14/01/2025